



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE - TIRANE
N. 12228 Rep.
N. 1388 Kol.

KONTRATE SHITJE
/aksioneve te shoqerise/

Sot, me daten 28.10.2003, perpara meje noterit, Agim Xh. Robo, anetar i Dhomes se Notereve, Tirane, ne zyren noteriale, ne Rrugen Ismail Qemali, P.27/1, u paraqiten palet kontraktuese, si me poshte : -----


SHITESIT : Shoqeria Alpturist sh.p.k., person juridik, regjistruar ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, me n. vendimi 16986, date 05.02.1997, perfaqesuar nga ortaku i vetem Irfan Hysenbelliu, n. pasaporte 1762730; Shoqeria Erjon sh.p.k., person juridik, regjistruar ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, me n. vendimi 7877, date 05.01.1995, perfaqesuar nga ortaku i vetem Irfan Hysenbelliu; Shoqeria IL 2 FA sh.p.k., person juridik, regjistruar ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, me n. vendimi 20041, date 22.09.1998, perfaqesuar nga ortaku i vetem Leonora Hysenbelliu, n. pasaporte 0903004 dhe Shoqeria Alco Systems sh.p.k., person juridik, regjistruar ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, me n. vendimi 21585, date 02.07.1999, perfaqesuar nga ortaku i vetem Irfan Hysenbelliu, te cilat zoterojne nga 25 % sejcila te aksioneve te shoqerise Egnatia Group sh.a., person juridik shqiptar i njohur dhe regjistruar rregullisht ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Tiranës; -----

BLERESI : Z. Irfan Hysenbelliu, lindur ne Skrapar, me 8 - prill 1959, banues ne Tirane, n. pasaporte 1762730; -----

te gjithë persona te ligjshem juridik dhe fizik, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentat perkatese te identifikimit, te cilet, me vullnetin e tyre te lire kerkuan redaktimin e kontrates se shitjes se aksioneve, me kushtet e meposhtme: -----

Shoqerite Alpturist sh.p.k., Erjon sh.p.k., IL 2 FA sh.p.k. dhe Alco Systems sh.p.k., jane aksionere ne shoqerine "Egnatia Group" sh.a., person juridik shqiptar, regjistruar ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Tiranës me n. vendimi 28285 date 23.09.2002, dhe zoterojne nga 25 % (njezetepese) sejcila te aksioneve te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie, duke perfaqesuar te gjithë kapitalin e saj dhe i shesin z. Irfan Hysenbelliu te gjitha keto aksione. -----
Çmimi i shitjes se tyre eshte i barabarte me vleren nominale te aksioneve, sipas regjistrimit ne regjistrin Tregetar. -----

Shitesit garantojne Bleresin qe aksionet, objekt i kesaj kontrate, jane plotesisht te disponueshme, te trasferueshme dhe te lira nga çdo lloj pengu, ipoteke apo barre tjeter ligjore. -----

 I dhur per sa me sipër, bleresi Irfan Hysenbelliu, behet pronar i aksioneve te shoqerise Egnatia Group sh.a. dhe aksioner i vetem i kesaj shoqerie. -----

Kontrata perpilohet ne nje faqe dhe tre kopje origjinale dhe ne baze te vullnetit te lire dhe te plote te personave pjesmarres. Pasi lexohet me ze te larte, deklarohet se eshte kuptuar, miratohet dhe firmoset rregullisht prej tyre dhe une noteri e vertetoj ate sipas ligjit. -----

Per, SHITESIT

BLERESI

Per, Alpturist sh.p.k.
Per, Erjoni sh.p.k.
Per, Alco Systems sh.p.k.

Irfan Hysenbelliu

Per, IL 2 FA sh.p.k.

Leonora Hysenbelliu

Irfan Hysenbelliu

